

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

Final sh.a

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Permbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-31

Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Për aksionerët e Final sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Final sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Pa kualifikuar opinionin tonë, terheqim vëmendjen ndaj shënimit 3.2 ku përshkruhet se Shoqëria nuk ka kryer ende një vlerësim mbi impaktin që do të ketë SNRF 9 mbi provigjionin e aktiveve financiare. Sipas kërkesave të SNRF 9, provigjioni mbi aktivet financiare duhet të përlogaritet sipas modelit të humbjeve te pritshme të ardhshme. SNRF 9 do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018.

Per me teper, në shënimin 3.2 përshkruhet se aktualisht, Shoqëria nuk ka vlerësuar ende impaktin e pritshëm për trajtimin e kontratave të qerasë sipas përkufizimit të ri SNRF 16. SNRF 16 do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Mediu Keshi, fut

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
28 Mars 2018



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	6	16,663	51,029
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	7	145,125	96,721
Hua dhene klienteve	8	45,576	10,628
Aktive afatgjata materiale	9	7,484	2,226
Aktive afatgjata jomateriale	10	499	1,924
Te drejta tatimore te shtyra	11	595	369
Parapagim tatim fitimit	12	-	482
Të tjera të arkëtueshme	13	31,264	20,898
Totali i aktiveve		247,206	184,277
Detyrimet			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	14	108,008	69,630
Detyrim tatim fitimi	12	2,982	-
Totali i detyrimeve		110,990	69,630
Kapitali			
Kapitali aksionar	15	100,000	100,000
Fitimi i mbartur		36,216	14,647
Totali i kapitalit		136,216	114,647
Totali i kapitalit aksionar dhe detyrimeve		247,206	184,277

Këto pasqyra u miratuan nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 28 shkurt 2018 dhe u firmosën nga:



Znj. Majlinda Demko
Drejtor i Përgjithshëm



Znj. Elda Toro
Drejtor i Departamentit të Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 31 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga qiraja financiare	16	83,439	55,270
Të ardhura nga kredidhënia	16	13,127	3,000
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	17	5,442	3,101
Totali i të ardhurave		102,008	61,371
Shpenzime personeli	18	(37,432)	(29,549)
Shpenzime të tjera operative	19	(21,749)	(11,340)
Provizione për llogaritë e arkëtueshme		(11,990)	(3,310)
Zhvierësimi dhe amortizimi		(3,305)	(2,587)
Fitim/humbja operative		(74,476)	(46,786)
Të ardhura financiare		24	58
Të ardhura/ (humbje) neto nga këmbimet valutore		6	(82)
(Shpenzimet) financiare neto	20	30	(24)
Humbja para tatimit		27,562	14,561
Tatimi mbi fitimin	21	(6,219)	(2,766)
Tatimi i shtyre	11	226	180
Humbja e vitit		21,569	11,976
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		21,569	11,976

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar se bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 31 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	(Humbja)/Fitimi e mbartur	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2015	100,000	2,671	102,671
Fitimi i vitit 2016	-	11,976	11,976
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	11,976	11,976
Gjendja më 31 dhjetor 2016	100,000	14,647	114,647
Fitimi i vitit 2017	-	21,569	21,569
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	21,569	21,569
Gjendja më 31 dhjetor 2017	100,000	36,216	136,216

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 31 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		27,562	14,561
<i>Sistemime për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	9,10	3,305	2,587
Provizjione për llogaritë e arkëtueshme	7,8	11,990	3,310
Të ardhura nga qiraja financiare		(83,439)	(55,270)
Të ardhura nga kredidhënia		(13,127)	(3,000)
Humbja operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues		(53,709)	(37,812)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
(Rritje) e të arkëtueshmeve nga qiraja financiare dhe huaja		(79,588)	(31,601)
(Rritje) e të arkëtueshmeve të tjera		(10,366)	(4,790)
Rritja e llogarive të pagueshme të aktivitetit dhe të tjera		38,378	34,619
Fluksi i parasë i gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet operuese		(105,285)	(39,584)
Interesi i arkëtuar		80,813	52,047
Tatim fitimi i paguar		(2,755)	(3,293)
Fluksi neto i parasë i gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet operuese		(27,227)	9,170
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(6,594)	(1,814)
Blerja e aktiveve afatgjata jomaterial	10	(544)	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese		(7,138)	(1,814)
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		(34,365)	7,356
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit		51,028	43,673
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit		16,663	51,029

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 31 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1. Të përgjithshme

FINAL sh.a. ("Shoqëria") është krijuar si një shoqëri aksionare më datë 11 janar 2008 me vendim të Gjykatës së Tiranës, në përputhje me Ligjin "Mbi shoqëritë tregtare" Nr. 7638 datë 19 nëntor 1992, më pas i amenduar, Ligjin "Mbi qiranë financiare" Nr. 9396, datë 12 maj 2005, të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, dhe Ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" Nr. 9662 më datë 18 dhjetor 2006 i ndryshuar, rregullores "Për licensimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendim nr.01, date 17 Janar 2013, te Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë për licensimin e veprimtarisë financiare "të gjitha format e kredidhënies".

Adresa zyrtare e shoqërisë është: Rr. "Papa Gjon Pali II", Pallati 11/1, Kati 5, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e qirave financiare ndaj individëve për blerjen e produkteve elektro-shtëpiake si dhe të gjitha format e kredidhënies.

Më 31 dhjetor 2017, kapitali aksionar i shoqërisë është 100,000 mijë Lek (2016: 100,000 mije Lek).

Struktura e aksionerëve të shoqërisë si më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
	%	%
River Styxx JSC	40.12	40.12
Balfin Sh.p.k	40.43	48.43
Z. Ali Vishaj	8.00	-
Z. Adrian Koni	11.45	11.45
Totali	100	100

River Styxx Capital është një shoqëri e themeluar në Sofie, Bullgari dhe ka si aksionar të vetëm z. Elvin Guri. Gjatë vitit 2018 në strukturën e aksionerëve të Shoqërisë është shtuar Zj. Majlinda Demko me 5% të aksioneve.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimeve nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Komitetit Ndërkombëtar të Interpretimit të Raportimit Financiar ("KNIRF") të BSNK-së. Politikat kontabël të adoptuara janë të qëndrueshme me ato të vitit të mëparshëm financiar.

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-të për çdo tip aktiviteti, detyrimi, të ardhure dhe shpenzimi janë të përshkruara detajisht në politikat kontabël të mëposhtme. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e një sërë vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël. Gjithashtu kërkon që drejtuesit e shoqërisë të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e aplikimit të politikave kontabël. Zërat të cilat përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti apo zërat ku gjykimet dhe vlerësimet janë domethënëse për pasqyrat financiare, janë përshkruar në Shënimin 4: Gjykime të rëndësishme kontabël dhe burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë. Shifrat krahasuese janë sistemuar për të qenë konform ndryshimeve në prezentimin e tyre në vitin aktual, nëse ka qënë e nevojshme.

3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Shoqërisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF "Instrumentet Financiare" 9

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhëzimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9, por nuk është ende në gjendje për të dhënë informacion sasior. Në këtë fazë fushat kryesore të ndikimit të pritshëm janë si më poshtë:

- klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Shoqërisë do të duhet të shqyrtohen në bazë të kriterëve të reja të cilat konsiderojnë flukset monetare kontraktuale të aktiveve dhe modelin e biznesit në të cilën ato janë administruar.
- një zhvlerësim i pritshëm me bazë humbje krediti do të duhet të njihet në të arkëtueshmet tregtare të Shoqërisë, nëse nuk klasifikohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me kriteret e reja.

Ndryshimet në vlerën e drejtë do të paraqitet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur Shoqëria bën një përcaktim të pakthyeshëm për të paraqitur ato në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018.

Shoqëria nuk ka ende kryer një vlerësim mbi impaktin për provigjonin mbi aktivet financiare, i cili sipas kërkesave të SNRF 9, duhet të përllogaritet sipas modelit të humbjeve të pritshme të ardhshme.

SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të ardhurat', 'SNK 11 Kontratat e ndërtimit', dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, furnizuesi opsione e riblerjes nga furnizuesit, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e Standardit të ri.

SNRF 15 hyn në fuqi në periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018. Shoqëria vlerëson se impakti nga IFRS 15 do të jetë i parëndësishëm për shkak të natyrës së aktivitetëve të saj.

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompletton projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar të kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje.

SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin e plotë të Standardit dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të japë informacion sasior.

Megjithatë, për të përcaktuar ndikimin Shoqëria është në proces të:

- kryerjes së një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve dhe për të vlerësuar nëse ndonjë kontratë shtesë tani do të bëhet një qira sipas përkufizimit të ri SNRF 16
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratojë; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsion lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përmbajnë, një qira, si edhe lehtësime të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rëndësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimit të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të aseteve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsionale kontabël do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimit të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëkohësisht
- vlerësimit për dhënie të informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria nuk ka vlerësuar ende impaktin e pritsëm për trajtimin e kontratave të qerasë sipas përkufizimit të ri SNRF 16.

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre.

3.2 Monedhat e huaja

a) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar që është monedha funksionale dhe prezantuese e shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në mijëshën më të afërt (Lek '000) përveç se kur është shprehur ndryshe.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet jo- monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivlerësohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u percaktua vlera e tyre e tregut.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqipëtar për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Njësia monetare e Bashkimit Europian (Euro)	132.95	135.23

3.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimësisë, i cili supozon se shoqëria do të vazhdojë të operojë për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017, shoqëria ka rezultuar me fitim neto në vlerën 20,583mijë Lek (2016: fitim neto në vlerën 11,976 mijë Lek).

Drejtimi i shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit të shoqërisë në kushtet aktuale. Aftësia e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin do të varet gjithashtu dhe nga mbështetja e vazhdueshme financiare nga aksionerët e saj.

Efektet e krizës financiare aktuale globale në sektorin e shërbimeve financiare mund të cojnë në reduktim të mëtejshëm të likuiditetit nga aktivitetet. Debitorët apo huamarrësit mund të ndikohen nga kjo situatë me likuiditet më të pakët dhe kjo mund të ndikojë në aftësitë e tyre për të shlyer paratë që detyrohen. Drejtimi i shoqërisë nuk është në gjendje të parashikojë të gjitha zhvillimet të cilat mund të kenë ndikim në ekonominë në përgjithsi dhe në atë të sektorit dhe për rrjedhojë efektet, nëse do ketë, mbi pozicionin e ardhshëm financiar të Shoqërisë.

3.4 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Kostot historike përfshijnë shpenzimet të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë koston e materialeve dhe të punës së shpenzuar, si dhe cdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e aktivit në kushte pune për qëllimin për të cilin janë krijuar, kostot e cmontimit dhe zhvendosjes së aktivit dhe kthimit të vendit të punës ku aktiviteti ishte vendosur në gjendjen e tij fillestare dhe kostot e huamarrjes që lidhen me aktivin e kualifikuar për t'u kapitalizuar.

Kur pjesë të ndryshme të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si pjesë më vete (komponentë kryesore) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëtejshme

Kostot e mëtejshme përfshihen në vlerën e mbetur kontabël të aktivit, apo njihen si aktiv më vete nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me aktivin në fjalë do të merren nga shoqëria dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e përditshme që i shërbejnë aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime të periudhës kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në metoden lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk amortizohet. Normat vjetore të amortizimit duke u bazuar në jetën e dobishme të vlerësuar janë si me poshtë:

	2017	2016
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%
Mobilje dhe orendi	20%	20%
Përmirësime të ambjenteve me qira	25%	25%

3.5 Aktivet afatgjata jomateriale

Njohja e aktiveve të tjera afatgjata jomateriale

(a) Program kompjuterik

Aktivet afatgjata jomateriale, përfshirë dhe programin kompjuterik të zhvilluar nga shoqëria maten me koston historike, ndërsa kostot e kapitalizuara amortizohen në bazë lineare mbi jetën e tyre të dobishme, pasi këto aktive konsiderohen si aktive me jetëgjatësi të përcaktuar. Vlera e tyre e mbetur si dhe jetëgjatësia e tyre e dobishme rishikohet cdo datë raportimi.

Programi kompjuterik i zhvilluar brenda shoqërisë, ka filluar të amortizohet që nga data 1 janar 2014. Amortizimi përlllogarit me metodën lineare në normën 25% në vit. Amortizimi përfshihet në zerin zhvlerësime dhe amortizime të aktiveve jo-financiare. Ky program është amortizuar plotësisht me 31 dhjetor 2017.

Kur një aktiv jomaterial shitet, fitimi apo humbja nga shitja përcaktohet duke krahasuar shumën e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.6 Instrumentat financiare

(a) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë para në dorë, vlerat monetare të pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe asetet financiare shumë likuide me maturitet fillestare më pak se tre muaj, të cilat nuk janë subjekt i një rreziku larte të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(b) Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut

Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk klasifikohen si aktive ose detyrime tregtare. Derivatet e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

(c) Kredite

Kreditë janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Shoqëria nuk ka për qëllim të shesë menjëherë ose në afatin e afërt.

Kur Shoqëria blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një aktiv të konsiderueshëm të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme ("repo e kundërt"), marrëveshja llogaritet si një hua ose paradhënie, dhe asktivi bazë nuk njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kreditë fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot shtesë të transaksionit direkt dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç kur Shoqëria zgjedh të mbajë kreditë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(d) Letrat me vlerë të investimeve

Letrat me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot shtesë të transaksionit të drejtpërdrejtë dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim ose të vlefshme për shitje.

(e) Investimet të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks, të cilat nuk plotësojnë përkufizimin e kredive të arkëtueshme, që Shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë pozitive për të mbajtur deri në maturim dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshëm për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i një shume më të vogël se investimet e mbajtura deri në maturim jo afër maturimit të tyre, do të rezultonte në riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe të parandalojnë Shoqërinë nga klasifikimi i letrave me vlerë të investimit si të mbajtura deri në maturim për dy vitet e tanishme dhe ato pasuese.

(f) Investime të disponueshme për shitje

Investimet e disponueshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat janë përcaktuar si të vlefshme për shitje ose nuk klasifikohen si një tjetër kategori e aktiveve financiare. Investimet e vlefshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kurset e këmbimit të investimeve të sigurisë së borxhit të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje.

Ndryshimet e tjera të vlerës së drejtë njihen drejtpërdrejt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse derisa investimi të shitet ose zhvlerësohet, me ç'rast fitimet dhe humbjet kumulative të njohura më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse njihen në fitim ose humbje.

(g) Të mbajtura për tregtim

Një aktiv financiar klasifikohet si i mbajtur për tregtim nëse:

- është blere kryesisht për qëllim të shitjes në terma afat shkurtër; ose
- në njohjen fillestare është pjesë e një portofoli të instrumenteve financiare të identifikuar që Shoqëria i menaxhon në grup dhe ka një model aktual të realizimit të fitimit në afatshkurtër; ose
- është një derivativ që nuk është përcaktuar dhe efektiv si një instrument mbrojtës.

Këto aktive financiare janë të shprehura me vlerën e drejtë, me çfarëdo fitimi ose humbje që rrjedh nga rivlerësimi i njohur në fitim ose humbje. Fitimi ose humbja neto e njohur në fitim ose humbje përfshin çdo dividend ose interes të fituar mbi aktivin financiar

C'rrregjistrimi

Aktivitetet financiare c'rrregjistrohen kur e drejta për të arkëtuar para nga këto aktive ka skaduar ose kur ato transferohen dhe Shoqëria ka transferuar gjithashtu të gjitha risqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë.

Matja e mëpasshme

Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje dhe aktivitetet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes mbahen më pas vlerën e tyre të tregut. Huatë dhe të arkëtueshmet dhe aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturitet mbahen me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi dhe humbjet e realizuara dhe të porealizuara nga ndryshimi i vlerës së tregut të aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes njihen në të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës në të cilën ndodhin. Fitimet dhe humbjet e porealizuara nga ndryshimi i vlerës së tregut në vlerën e aktiveve jo-monetare të të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe kalojnë në rezervë. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të vlefshme për shitje shiten ose identifikohen si të zhvlerësuara, fitimi ose humbje e akumuluar njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohet nga rezervat në të ardhura shpenzime dhe paraqitet si axhustim riskklasifikimi brenda të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Interest e letrave me vlerë të vlefshme për shitje llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në të ardhura shpenzime. Dividentët e instrumentave të kapitalit të vlefshme për shitje njihen në të ardhura dhe shpenzime kur Shoqëria ushtron të drejtën e saj për të marrë para. Të dyja përfshihen në zërin të ardhura nga investimet.

Vlera e tregut e investimeve të kuotuar bazohet në cmimin aktual të ofruar. Nëse nuk ekziston një treg aktiv për aktivin financiar, Shoqëria vendos vlerën e tregut të aktivitetit duke përdorur teknikat e vlerësimit. Këto përfshijnë referimet të transaksioneve të ngjashme të fundit, referimit ndaj instrumentave të tjerë të cilat thelbësisht janë të ngjashme, analizat e parasë së skontuar etj.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë huamarrjet dhe llogaritë e pagueshme të aktivitetit dhe të tjera të pagueshme. Detyrimet financiare maten fillimisht me vlerë tregu axhustuar për kostot e transaksionit që janë të lidhura direkte blerjen e tyre. Detyrimet financiare njihen më pas me koston e tyre të amortizuar me ndonjë diferencë midis kostos dhe vlerës në fund që njihet në të ardhura shpenzime përgjatë periudhës së detyrimit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kompesimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompeshen me njëra tjetrën dhe paraqiten në vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston e drejta ligjore për të kompeshuar vlerat e rregjistruara dhe ekziston qëllimi për të paraqitur në vlera neto ose për të realizuar aktivin dhe mbyllur detyrimin në të njëjtën kohë.

3.7 Qiraja

Një qira përcaktohet si një kontratë e detyrueshme ku qiradhenësi i jep qiramarrësit në këmbim të një pagese ose një serie pagesash, të drejtën për të përdorur një aktiv për një periudhë të caktuar kohore. Një qira mund të klasifikohet si financiare ose e zakonshme.

Qiraja financiare është qiraja ku në mënyrë të konsiderueshme janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e një pronësie faktike mbi aktivin ndaj qiramarrësit. Pronësia e aktivit mund të transferohet ose jo në përfundim të qirase. Qira të zakonshme janë të gjitha qiratë e tjera të ndryshme nga qiraja financiare. Shoqëria njeh aktivet e dhëna me qira financiare si të arkëtueshme në bilancin e saj kontabël në një shumë të barabartë me investimin në qira. Investimi neto në qira është vlera bruto e investimit në qira e aktualizuar me normen e nënkuptuar të interesit në qira. Norma e nënkuptuar e interesit në qira është norma e aktualizimit e cila, në fillim të qirasë, barazon totalin e vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë dhe vlerës së mbetur të paguarantuar të barabartë me shumën e vlerës së drejtë të aktivitet të dhënë me qira si edhe të kostove direkte të kryera nga qiradhenësi. Diferenca midis vlerës bruto të arkëtueshme dhe vlerës aktuale të arkëtueshme është e ardhur financiare e pafituar. E ardhura nga qiraja financiare njihet përgjatë periudhës së qirase në baza sistematike duke përdorur metoden e investimit neto, e cila pasqyron një normë kostante kthimi mbi investimin neto të qiradhenësit.

3.8 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizuar.

Në cdo datë të pasqyrës financiare, Shoqëria vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Një grup financiar ose grup aktivesh financiare zhvlerësohet dhe humbet nga zhvlerësimi njihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë i ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktiviteti (një 'ngjarje e humbur') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim në flukset e ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar ose të një grupi aktivesh financiare që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Dëshmi objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e Shoqërisë në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose debitorit;
- b) Shkelja e kontratës, si vonesa në pagesa e penalitete;
- c) Mundësia që emetuesi ose debitori do të hyjë në proces falimentimi ose në riorganizime të tjera financiare;
- d) Zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar si rezultat i vështirësive financiare; ose

3.8 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

- e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga një grup aktivesh financiare që nga njohja fillestare të tyre, megjithëse rënia ende nuk mund të identifikohet specifikisht me një aktiv financiar të Shoqërisë, duke përfshirë:
- Ndryshime jo të favorshme në statusin e pagesave të emetuesit ose debitorit; ose
 - Kushtet ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve të Shoqërisë.

Së pari, Shoqëria shikon nëse ekziston një evidencë objektive e zhvlerësimit veç e veç për aktivet financiare të cilat janë individualisht të rëndësishme. Në qoftë se Shoqëria gjykon se nuk ekziston një evidencë objektive e zhvlerësimit për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, atëherë ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe i vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre. Aktivet që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat është njohur ose vazhdon të njihet humbja nga zhvlerësimi nuk përfshihen në vlerësimin në mënyrë kolektive të zhvlerësimit.

Në qoftë se ka një evidencë objektive që tregon për një humbje nga zhvlerësimi në huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, të vlerësuara me koston e amortizuar, madhësia e humbjes përcaktohet si diferenca midis vlerës kontabël të aktiveve dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur) skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar (d.m.th. norma e interesit efektiv llogaritur qysh në njohjen fillestare). Vlera kontabël neto e aktivit do të zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes. Vlera e humbjes do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Nëse një investim i mbajtur deri në maturim ose një hua ka një normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e zhvlerësimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar sipas kontratës. Si praktikë e njohur shoqëria mund të mase zhvlerësimin e një instrumenti financiar në baze të vlerës së drejtë duke përdorur një cmim të vëzhguar të tregut.

Për qëllime të testimit kolektiv, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kreditit (psh. Në bazë të procesit të vlerësimit të Grupit që konsideron llojin e aktivit, statusin e pagesave dhe faktore të tjera të lidhura). Keto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të tilla aktivesh duke qenë tregues i aftësisë së emetuesit për të paguar të gjitha shumatat sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit në vlerësim.

Në qoftë se, në një periudhë të mevonshme, shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi zhvlerësimi ishte njohur (të tilla si përmirësimi i indeksit të kreditit), humbja e njohur me pare nga zhvlerësimi ndryshohet duke rregulluar llogarinë e rezervës. Shumata e ndryshimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabel a aktiveve afatgjata jo-financiare, pervec inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyre, rishikohet ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese nje tregues i tille ekziston, atehere behet vleresimi i shumes te rekuperueshme te aktivitetit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktiviteti apo e njesise gjeneruese te flukseve monetare te tij tejkalon vleren e rikuperueshme. Nje njesi gjeneruese mjetesh monetare eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse monetare te cilat jane te pavarura ne menyre te konsiderueshme nga aktive apo grupe te tjera. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Vlera e rekuperueshme e nje aktiviteti apo njesie gjeneruese eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se tij te drejte pas zbritjes se kostove te shitjes. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme zbritjeje (para tatimit) qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike te aktivitetit.

Humbja e zhvleresimit rimeret nese ka patur ndryshim ne vleresimet e perdorura per te percaktuar vleren e rikuperueshme. Humbja e zhvleresimit rimeret deri ne masen qe vlera e mbetur e aktivitetit nuk tejkalon vleren e mbetur qe do te ishte percaktuar, pas zbritjes se amortizimit, nese nuk do te ishte njohur asnje humbje zhvleresimi.

3.9 Kapitali

Kapitali i Shoqerise perbehet nga parate e kontribuara nga themeluesit e Shoqerise. Kapitali i Shoqerise mbahet me vleren ekuivalent ne Lek te kontributit te marre ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit te dates se transaksionit. Kapitali i nenshkruar i Shoqerise njihet me vleren nominale te tij.

3.10 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare perfshijne mjete monetare ne arkë, llogari rrjedhese ne banka dhe mjete te tjera likuide me maturitet jo me shume se tre muaj te cilat jane subjekt i ndryshimeve jo-sinjifikative ne vleren e tyre te tregut dhe qe perdoren nga Shoqeria ne manaxhimin e angazhimeve te saj afatshkurtra. Mjetet monetare mbahen ne vleren e tyre te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

3.11 Njohja e te ardhurave

E ardhura perfshin vleren e drejte te shumes te arketuuar ose te arketueshem ne lidhje me shitjen e mallrave ose sherbimeve pergjate aktivitetit normal te shoqerise. E ardhura paraqitet neto nga tatimi mbi vleren e shtuar.

Shoqeria njeh te ardhurat atehere kur shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme, eshte e mundur qe shoqeria te kete perfitime te ardhshme ekonomike. Te ardhurat nga qiraja financiare njihen pergjate afatit te qirasë duke perdorur metodën e investimit neto, e cila pasqyron nje norme kostante kthimi mbi investimin neto te qiradhënsit. Te ardhurat nga interesi njihen ne menyre proporcionale me kohën duke perdorur normën efektive te interesit.

3.12 Te ardhura te tjera operative

Te ardhura te tjera operative perfshijne komisione dhe tarifa te tjera administrative qe lidhen me administrimin e qirase financiare, te cilat jane njohur pergjate kohes se kryerjes se sherbimit.

3.14 Perfitimet e punonjesve

Sigurimet shëndetësore dhe shoqërore të detyrueshme

Ne rrjedhen normale te biznesit shoqëria, kryen pagesa me emer te vet dhe ne emer te punonjesve te saj per te kontribuar ne pensionin e detyrueshem sipas legjislacionit lokal. Kostot e pesuara nga ana e shoqërise jane ngarkuar ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

3.15 Te tjera shpenzime operative

Shpenzimet e tjera operative njihen mbi bazen e kontabilitetit rrites kur ato ndodhin.

3.16 Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyre

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin njihet ne te ardhura shpenzime pervec se kur ai i referohet zerave te njohura direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera gjithpërfshirese. Tatimi aktual është tatimi i prituri i pagueshëm mbi fitimin e taksueshem të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara apo të miratuara në masë substanciale në datën e bilancit, dhe ndonjë rregullim të tatim fitimit të pagueshëm lidhur me vitin e mëparshëm. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% mbi fitimin e tatueshem.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke krijuar provigjon për diferencat e përkohshme midis bazës tatimore dhe vlerave të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi apo që do të hyjë më vonë në fuqi përgjatë periudhës së rimarrjes.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të vlefshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen në masën që përfitimet tatimore në lidhje me to janë të mundshme të realizohen.

3.17 Provigjonet

Provigjonet njihen atëhere kur Shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, ka më shumë mundësi se sa jo që një reduktim burimesh do të jetë i nevojshëm për të shlyer detyrimin si dhe shumën mund të vlerësohet me besueshmëri.

Nese efekti i tyre është i konsiderueshem, provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me nje norme para taksave qe reflekton vleresimin aktual te vleres ne kohe te parase dhe ku është e nevojshme, risqet specifike të lidhura me detyrimin. Provigjonet rishikohen cdo data raportimi dhe nese nuk ka me mundesi qe nje reduktim burimesh te kerkohet per te shlyer detyrimin, provigjonet duhet te anulohen. Provigjonet perdoren vetem per qellimin per te cilin u krijua fillimisht. Provigjonet nuk njihen per te mbuluar humbjet e ardhshme operative aktivet dhe detyrimet e mundshme nuk njihen.

3.18 Transaksionet me palet e lidhura

Transaksionet me palet e lidhura përfshijnë aksioneret dhe drejtoret e Shoqërise, se bashku me entitete që ato kontrollojnë të cilët mund të ushtrojnë influence të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e Shoqërise. Duke konsideruar cdo pale të mundshme të trete vemendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetem formes ligjore.

3.19 Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por paraqiten ne shenimet sqaruese kur nje hyrje e perfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3.20 Ngjarjet pas dates së raportimit

Ngjarjet pas dates së raportimit të cilat vëne në dispozicion informacion shtesë mbi pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrave të pozicionit financiar (ngjarje rregulluese), reflektohen në pasqyrat financiare të konsoliduara. Ngjarjet pas dates së bilancit të cilat nuk janë ngjarje rregulluese, paraqiten në shenimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Gjykimet kontabel dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në aplikimin e politikave kontabel të shoqërisë të cilat paraqiten në shenimin 3, drejtimit i kërket që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen rregullisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet, nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën aktuale dhe të ardhshme.

Pasiguri në gjykim

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në çdo datë të pasqyrës të pozicionit financiar. Drejtimi gjykon që jeta e përcaktuar e dobishme të aktiveve përfaqëson dobinë e pritshme të aktiveve. Vlerat e mbartura të këtyre aktiveve janë analizuar në shenimet 7 dhe 8. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të daljeve jashtë përdorimit nga ndryshimet teknologjike.

Inventari

Inventari njihet me vlerën me të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Në vlerësimin e vlerës neto të realizueshme drejtimi merr në konsideratë evidencën me të fundit të vlefshëm në momentin kur bëhet vlerësimi.

b) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Humbja nga zhvlerësimi i qirase financiare

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arketueshmet e saj nga qiraja financiare. Gjatë kryerjes së këtyre testeve shoqëria mer parasysh pagesat e rregullta të bera nga qiramarrësit, pra debitori, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arketueshmerinë e pagesave nga instrumentat financiare dhe një numër kriteresh të tjera të përdorura për të vlerësuar arketueshmerinë e qirase financiare. Shoqëria konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivitetet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta rreziku.

Humbja nga zhvlerësimi i kredisë

Shoqëria rishikon portofolet e saj të huave për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Shoqëria bën gjykime nëse ka të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një portofol kredisë para se të mund të identifikohet rënia me një hua individuale në atë portofol. Kjo mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesave të huamarrësve në një grup ose në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjes për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe dëshmi objektive të zhvlerësimit të ngjashëm me ato të portofolit gjatë caktimit të flukseve monetare të ardhshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhshme të parasë rishikohen rregullisht për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

Rreziqet e ndodhura por jo të identifikuar

Kreditë individuale të vlerësuara për të cilat nuk është identifikuar evidence e humbjes janë grupuar së bashku sipas karakteristikave të tyre të rrezikut të kredisë me qëllim të llogaritjes së humbjes kolektive të vlerësuar. Kjo vjen nga zhvlerësimi në datën e bilancit, i cili do të identifikohet individualisht në të ardhmen.

Provizioni kolektiv për zhvlerësim përcaktohet duke marrë parasysh:

- përvojën e humbjes historike në portofolet me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë (për shembull, sipas sektorëve të industrisë, klasës së huasë ose produktit);
- periudhën e parashikuar midis zhvlerësimit që ndodh dhe humbjes së identifikuar e cila evidentohet me krijimin e një provizioni të përshtatshëm ndaj kredisë individuale; dhe
- gjykimi nga përvoja i drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që niveli aktual i humbjeve të natyrshme ka të ngjarë të jetë më i madh apo më i vogël se ai i sugjeruar nga përvoja historike.

Periudha ndërmjet humbjes që ndodh dhe identifikimit të saj vlerësohet nga drejtimi për çdo portofol të identifikuar.

Grupet homogjene të kredive

Për grupet homogjene të kredive që nuk konsiderohen si të rëndësishme në mënyrë individuale, përdoren dy metoda alternative për llogaritjen e provizionin në bazë të portofolit:

- Kur ekziston informacioni i duhur empirik, grupi përdor metodologjinë e normës historike. Kjo metodologji përdor një analizë statistikore të tendencave historike të probabilitetit të vonesës dhe shumës së humbjes pasuese, të vlerësuar në çdo periudhë kohore për të cilën pagesat kontraktuale të klientit janë të vonuara. Humbja e vlerësuar është dallimi mes vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme të ardhshme, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të portofolit dhe vlerës kontabël të portofolit. Të dhënat e tjera historike dhe kushtet aktuale ekonomike gjithashtu vlerësohen kur llogaritet niveli i duhur i provizionit të kërkuar për të mbuluar humbjet e pandara. Në disa tregje mjaft të zhvilluara, modelet e sofistikuar gjithashtu marrin parasysh trendet e sjelljes dhe të menaxhimit të llogarive siç tregohet, për shembull, në statistikat e falimentimit dhe riplanifikimit.

Në raste të tjera, kur madhësia e portofolit është e vogël ose kur informacioni është i pamjaftueshëm ose nuk është i besueshëm sa duhet për të adoptuar një metodologji të normës historike, shoqëria miraton një metodë formulare e cila ndan shkallën progresive të humbjeve në përqindje më të lartë në përputhje me periudhën kohore për të cilën kredia është vonuar. Normat e humbjeve llogariten nga flukset monetare të ardhshme të pritshme të skontuara nga një portofol.

Normat e historike, normat e humbjeve dhe koha e pritshme e rikuperimit të ardhshëm krahasohen rregullisht me rezultatet aktuale për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme.

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Shoqëria përdor metodën e normës historike duke vlerësuar shumën e humbjes pasuese si diferencë midis vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme të ardhshme, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të portofolit dhe vlerën kontabël të portofolit. Për shkak se vlera kohore e parasë nuk është e rëndësishme për shkak të periudhës së shkurtër të marrëveshjeve të qirasë financiare, humbja është shuma e barabartë me: $A * B * D$, ku:

A: Portofoli i kredisë sipas grupeve

B: normat historike te probabilitetit te mos pageses

C: i provigjionuar me normë të lartë, > 75%, plus kreditë e fshira; ose

C: arketimet aktuale nga kreditë me vonese me te madhe se 365 ditë

D: Norma e Humbjes = $C / \text{Portofoli i Kredisë me vonese me te madhe se 365 dite}$.

5 Menaxhimi i riskut financiar

Faktoret e riskut financiar

Politikat dhe procedurat e Shoqërisë sigurojnë direktiva për monitorimin dhe menaxhimin e risqeve financiare gjate ushtrimit te aktivitetit. Këto risqe përfshijnë riskun e kredise, riskun e tregut (qe përfshin rikun e kursit te kembimit dhe riskun e normave te interesit) dhe riskun e likuiditetit.

Menaxhimi i riskut behet nga drejtimi i Shoqërisë bazuar ne disa politika dhe procedura te shkruara e te para aprovuara qe mbulojne menaxhimin e pergjithshem te riskut sikurse dhe me specifkisht riskun e kursit të këmbimit, riskun e normave te interesit, riskun e kredisë, si dhe përdorimin e masave të duhura për të investuar likuiditetin e tepërt.

Instrumentet financiare sipas kategorive paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2017	Huate dhe te arketueshmet	Aktivet me vleren e drejte permes fitimit dhe humbjes	Aktive te vlefshme per shitje	Total
Aktivet sipas Pozicionit Financiar				
Kredi, neto				
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	45,576	-	-	45,576
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	145,125	-	-	145,125
Total	16,663	-	-	16,663
		Detyrimet me vlere te drejte permes fitim-humbjes	Detyrime financiare te tjera	Total
Detyrimet sipas pozicionit financiar		-	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera		-	108,008	108,008
Total		-	108,008	108,008

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

31 dhjetor 2016	Huate dhe te arketueshmet	Aktivitet me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Aktive te vlefshme per shitje	Totali
Aktivitet sipas pasqyrës së pozicionit financiar				
Kredi neto	10,628	-	-	10,628
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	96,721	-	-	96,721
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	51,029	-	-	51,029
Total	158,378	-	-	158,378
		Detyrimet me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Detyrime financiare te tjera	Total
Detyrimet sipas pasqyrës së pozicionit financiar				
Llogari të pagueshme dhe të tjera		-	63,960	63,960
Total		-	63,960	63,960

(a) Risku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut nepermjet perdorimit të instrumentave të saj financiare dhe specifikisht ndaj riskut të normave të interesit që lindin si nga aktivitetet e saj operative ashtu dhe nga aktivitetet investuese.

Risku i kursit të kembimit

Shoqëria nuk kryen veprime në monedhe të huaja dhe për rrjedhojë nuk është e ekspozuar nga luhatjeve të kurseve të kembimit.

Risku i normave të interesit të vlerës së drejtë dhe fluksit të parasë

Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset operative të parasë janë kryesisht të varura nga ndryshimet në normat e interesit në treg. Risku nga normat e interesit të shoqërisë kryesisht vjen nga qiradhënia, si dhe nga aktivitetet dhe nga huatë që kanë interesa. Qiradhëniet me norma të interesit të ndryshueshme dhe huatë me norma të interesit fikse ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të normave të interesit të flukseve të parasë. Në mënyrë që të përballohet ekspozimi ndaj këtij risku, Shoqëria kontraktonte marrëveshje qiradhënie me klientët me kushte të përafërta me kushtet me të cilat sigurohen fondet. Qiratë financiare rivlerësohen vazhdimisht për të reflektuar zhvillimet e tregut.

Si rezultat i më sipër, shoqëria arrin në një masë të gjerë përputhjen e riskut nga ricimimi i aktiveve dhe detyrimeve duke minimizuar riskun ndaj normës së interesit. Nëse vlera e tregut e normave të interesit ndryshon, ky ndryshim nuk do të ketë ndikim të madh në rezultatin financiar të Shoqërisë.

(b) Risku i kredise

Risku i kredise është rreziku që pala tjetër nuk arrin të përmbushë një detyrim ndaj Shoqërisë. Ekspozimi total ndaj riskut të kredise për shoqërinë në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	2017	2016
Kredi, neto	45,576	10,628
Te arketueshme nga qiraja financiare	145,125	96,721
Mjetet monetare	16,663	51,029
Total	207,364	158,378

Shoqëria ka vendosur politika në mënyrë që të sigurojë shërbimet financiare të kryen ndaj klientëve me histori krediti të përshtatshme.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Manaxhimi i riskut të kredisë realizohet nëpërmjet:

- Formulimit të politikave të riskut të kredisë që përmbajnë kritere për vlerësimin e kredisë, klasifikimit dhe raportimit të riskut, dokumentat dhe procedurat ligjore dhe përputhjen me kërkesat ligjore dhe rregullatore.
- Krijimit dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzuar në lidhje me aprovimin e kredive
- Rishikimit dhe rivlerësimit të riskut të kredise.
- Zhvillimi dhe mbajtja e kategorive të riskut të Shoqërisë në mënyrë që të kategorizohet ekspozimi në përputhje me masën e rrezikut të humbjes financiare të përballuar dhe të fokusohet menaxhimi në risqet aktuale. Sistemi i kategorizimit të kredisë përdoret kur duhet të përcaktojnë provigjionet për zhvlerësim të ekspozimeve specifike të kredisë.
- Aktivitetet e dhëna me qira rimerren nga Shoqëria në rast se kontrata zgjidhet për arsye të mospërmbushjes së termave të saj nga qiramarrësi.
- Në rastet e mospërmbushjes së termave të kontratës së kredisë Shoqëria mund të drejtohet gjykatës ose të për zgjedhe një Shoqëri përmbartimore për mbledhjen e detyrimit.

Të arkëtueshmet e qirasë financiare që nuk kanë regjistruar vonesa dhe nuk janë zhvlerësuar përfaqësojnë kontratat e qirasë me asnjë ditëvonesë në ripagimin e principalit dhe interesit. Portofoli i qirasë testohet për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

Nuk ekzistojnë përqëndrime të rëndësishme të riskut të kredise për shkak se portofoli i qiradhënies dhe kredisë është i formuar nga një numër i madh klientësh të vegjël.

Shoqëria ka zhvilluar një sistem për vlerësimin e aftësisë kredimarrëse dhe gjendjes të klientëve të portofolit të qiradhënies që nuk tregojnë asnjë evidencë zhvlerësimi, i cili është përcaktuar në baza portofoli, dhe varet nga datat e pagesës në bazë të kontratave.

(b) Risku i kredisë

Kreditë dhe qiraja financiare e arkëtueshme e Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 disa kategorive të dite vonesave paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2017	Të arkëtueshme nga qiraja financiare dhe kredia, bruto		Të arkëtueshme nga qiraja financiare dhe kredia, neto	
		Zhvlerësimi		
30 dite pas afatit	167,669	(764)		166,905
Brënda 31-90 ditë pas afatit	14,917	(3,281)		11,636
Brënda 91-180 ditë pas afatit	8,758	(4,105)		4,653
Brënda 181-356 ditë pas afatit	11,905	(7,220)		4,685
Pas 361 ditë pas afatit	13,816	(10,994)		2,822
Totali	217,065	(26,364)		190,701

Qiraja financiare e arkëtueshme e Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

31 dhjetor 2016	Të arkëtueshme nga qiraja financiare, bruto		Të arkëtueshme nga qiraja financiare, neto	
		Zhvlerësimi		
30 dite pas afatit	102,286	(1,039)		101,247
Brënda 31-90 ditë pas afatit	4,145	(1,218)		2,927
Brënda 91-180 ditë pas afatit	2,802	(1,642)		1,160
Brënda 181-356 ditë pas afatit	3,507	(2,751)		756
Pas 361 ditë pas afatit	11,102	(9,843)		1,259
Totali	123,842	(16,493)		107,349

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Risku i kredisë i fondeve likuide është i limituar sepse kuderpartite janë banka me nivel të lartë të vleresimit të kreditimit të atribuara nga agjencite nderkombetare të vleresimit të kreditimit.

Risku i kredisë i lidhur me të arketueshmet nga qiraja financiare është i zvogeluar sepse të arketueshmet nga qiraja financiare janë të siguruar nga pajisjet e dhëna me qira.

Politikat e fshirjes nga pasqyrat financiare

Shoqëria i fshin të arketueshmet nga qiraja financiare nga pasqyrat e saj financiare (dhe provigjionin e lidhur me to) pasi drejtimi vendos që ato janë të pambledhshme. Vendimi bazohet në analizen e bere vonesave në ri-pagime të qirase dhe ndodhjen e ndryshimeve të rendesishme në pozicionin financiar të klientit që bëjnë të pamundur shlyerjen e detyrimeve nga klienti, si dhe pasi vlerësohet që ardhura nga shitja e produktit të dhene me qira nuk do të mbulonte ekspozimin e klientit ndaj Shoqërisë.

(c) Risku i likuiditetit

Shoqëria administron riskun e likuiditetit duke mbajtur një gjendje të mjaftueshme të parave, duke përdorur facilitete bankare dhe facilitete të huave rezerve, duke bere monitorim të vazhdueshëm të flukseve aktuale dhe të parashikuara të parase si dhe duke përputhur maturimin e aktiveve me detyrimet financiare.

Tabela më poshtë analizon afatin kontraktual të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë me periudhën e shlyerjes të rene dakort:

31 dhjetor 2017

	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët financiarë				
Kredi, neto	-	45,576	-	45,576
Të arkëtueshme nga qiraja financiare dhe kredidhenia	-	145,125	-	145,125
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	16,663	-	-	16,663
Total	16,663	190,701	-	207,364
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera	76,187	31,821	-	108,008
Total	76,187	31,821	-	108,008
Pozicioni neto	(59,524)	158,880	-	99,356

31 dhjetor 2016

	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktive financiare				
Kredi neto	-	10,628	-	10,628
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	-	96,721	-	96,721
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	51,029	-	-	51,029
Total	51,029	107,349	-	158,378
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera	36,108	27,852	-	63,960
Total	36,108	27,852	-	63,960
Pozicioni neto	14,921	79,497	-	94,418

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

6. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paraja në bankë		
Llogari në monedhe te huaj – Euro	201	197
Llogari në Lek	16,427	50,829
Arka në Lek	35	3
Totali	16,663	51,029

7. Të arkëtueshmet nga qiraja financiare

Të arkëtueshmet nga qiraja financiare analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te arkëtueshme nga qiraja financiare, bruto	165,165	111,646
Zhvleresimi	(20,040)	(14,925)
Të arkëtueshme nga qiraja financiare, neto	145,125	96,721

Të arkëtueshmet nga qiraja financiare, bruto:

	Pagesat minimale te pritshme të qirasë	Vlera aktuale e pagesave minimale të pritshme të qirasë	Pagesat minimale të pritshme të qirasë	Vlera aktuale e pagesave minimalë te pritshme të qirasë
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2016
Për vitin e ardhshëm	239,791	165,165	140,677	111,646
Për pesë vitet e ardhshme	-	-	-	-
Për vitet e tjere mbas vitit të pestë	-	-	-	-
Totali i pagesave minimale të mevonshme të qirasë	239,791	165,165	140,677	111,646
Zbritur: Interesin e pritshem	(74,626)	-	(29,031)	-
Totali i vlerës aktuale të pagesave minimale të mevonshme të qirasë	165,165	165,165	111,646	111,646

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Per vitin e ardhshëm	165,165	111,646
Pas nje viti por jo me shume se pese vjet	-	-
Pas pese vjetesh	-	-
Totali	165,165	111,646

Fondi i zhvleresimit per llogarite e arkëtueshme te dyshimta eshte krijuar bazuar ne klasifikimin e rrezikut sic eshte shpjeguar ne shenimin 5 "Rreziku i kreditit".

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Levizjet ne fondin e zhvleresimit per llogarite e arketueshme te cilat lidhen teresisht me llogaritë e arketueshme nga qiraja financiare jane si me poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Me 1 janar	14,925	13,246
Zhvleresimi per vitin	7,234	1,742
Crregjistrimi	(2,119)	(63)
Me 31 dhjetor	20,040	14,925

Gjate vitit 2017, drejtimi i Shoqerise vendosi te crregjistroje nga llogarite e arketueshme nga qiraja financiare shumen prej 2,254 mijë Lek (2016: 62 mijë Lek) te cilat ishin me vonese prej me shume se 365 ditesh per arsye te problemeve me likuiditetin.

8. Kredi, neto

Kredi, neto analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kredi, bruto	51,900	12,196
Zhvleresimi per vitin	(6,324)	(1,568)
Kredi, neto	45,576	10,628

Levizjet ne fondin e zhvleresimit per llogarite e arketueshme te cilat lidhen teresisht me kredidhenien jane si me poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Me 1 janar	1,568	-
Zhvleresimi per vitin	4,756	1,568
Me 31 dhjetor	6,324	1,568

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

9. Aktivet afatgjata materiale

Kosto	Permiresimet e ambienteve te marra me qira					Totali
	Permiresimet e ambienteve te marra me qira	Mobilije dhe orendi	Kompjutera	Mjete transporti		
Gjendja me 31 dhjetor 2015	538	939	2,945	1,329	5,751	
Shtesa	-	340	1,474	-	1,814	
Pakesime	-	-	(307)	-	(307)	
Gjendja me 31 dhjetor 2016	538	1,279	4,112	1,329	7,258	
Shtesa	1,571	1,155	1,370	2,498	6,594	
Pakesime	-	-	-	(1,329)	(1,329)	
Gjendja me 31 dhjetor 2017	2,109	2,434	5,482	2,498	12,523	
Zhvleresimi i akumuluar						
Gjendja me 31 dhjetor 2015	(361)	(695)	(2,270)	(1,310)	(4,636)	
Zhvleresimi i vitit	(108)	(145)	(431)	(19)	(703)	
Rimarrje amortizimi	-	-	307	-	307	
Gjendja me 31 dhjetor 2016	(469)	(840)	(2,394)	(1,329)	(5,032)	
Amortizimi i Vitit	(202)	(236)	(673)	(225)	(1,336)	
Rimarrje Amortizimi	-	-	-	1,329	1,329	
Gjendja me 31 dhjetor 2017	(671)	(1,076)	(3,067)	(225)	(5,039)	
Vlera kontabel neto						
Gjendja ne 31 dhjetor 2016	69	439	1,718	-	2,226	
Gjendja mne 31 dhjetor 2017	1,438	1,358	2,415	2,273	7,484	

Ne 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Shoqëria nuk ka kolateral mbi aktivet e saj materiale. Nuk ka angazhime kontraktuale për të blerë ndonjë aktiv material më 31 dhjetor 2017.

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

10. Aktivet afatgjata jomateriale

Kosto	Aktive materiale		Totali
	Software	te tjera	
Gjendja me 31 dhjetor 2015	7,272	462	7,734
Shtesa	-	-	-
Ne 31 dhjetor 2016	7,272	462	7,734
Shtesa	-	544	544
Ne 31 dhjetor 2017	7,272	1,006	8,278
Amortizimi i akumuluar			
Me 31 dhjetor 2015	(3,636)	(290)	(3,926)
Amortizimi i vitit	(1,818)	(66)	(1,884)
Gjendja me 31 dhjetor 2016	(5,454)	(356)	(5,810)
Amortizimi i vitit	(1,818)	(151)	(1,969)
Gjendja me 31 dhjetor 2017	(7,272)	(507)	(7,779)
Vlera kontabel neto			
Gjendja ne 31 dhjetor 2016	1,818	106	1,924
Gjendja ne 31 dhjetor 2017	-	499	499

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

11. Të drejta tatimore të shtyra

Gjate vitit 2017 dhe 2016, drejtimi i Shoqërisë ka njohur një aktiv tatimor të shtyre në masën që është e mundur që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë të vlefshme kundrejt të cilave diferencat e perkohshme të mund të perdoren.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Me 1 janar 2016	369	189
Tatimi fitimi i shtyre që rezultojnë nga amortizimi kontabël i përshpejtuar	226	180
Aktiv tatimor i shtyrë	595	369

12. Parapagim tatim fitimi

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjendje më 1 Janar	(482)	45
Tatim fitimi i paguar gjate vitit	(2,755)	(3,293)
Tatim fitimi i vitit ushtrimor	6,219	2,766
(Detyrim)/parapagim tatim fitimi	2,982	(482)

13. Të tjera të arketueshme

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Te arketueshme për TVSH, neto	29,510	20,210
Paradhenie për punonjësit	1,328	160
Inventare	426	528
Totali	31,264	20,898

Të arketueshme për TVSH, neto përfshijnë një shumë prej 5,323 (2016 5,243) mijë Lek që ka lidhje me faturat me TVSH të lëshuara nga furnizuesit e pajisjeve të dhëna me qira, të cilat nuk kanë mbërritur në Shoqëri në datën e raportimit dhe si rrjedhojë nuk janë deklaruar në autoritetet tatimore në datën e raportimit. Keto fatura lidhen me paisjet e blera nga Shoqëria nga këto furnitore gjatë periudhës të raportimit. Për këtë arsye një përlllogaritje është kryer si në lidhje me detyrimet për furnitoret ashtu dhe për llogaritë e arkëtueshme të tjera.

14. Llogari të pagueshme dhe të tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitore për paisjet me qira	93,365	62,163
Parapagime nga klientë	10,335	3,288
Shpenzime të llogaritura	1,230	1,653
Te pagueshme për punonjësit	1,033	991
Detyrime tatimore dhe sigurime shoqërore	1,112	729
Të tjera të pagueshme	933	806
Totali	108,008	69,630

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

15. Kapitali aksionar

Kapitali është paraqitur si kapitali i nënshkruar dhe i paguar në vlerën e 100.000 mijë Lekë. Struktura e kapitalit aksionar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është si vijon:

	31 dhjetor 2017				31 dhjetor 2016			
	Nr. i aksioneve	% e aksioneve	Vlera në Lekë	Vlera në mijë Lekë	Nr. i aksioneve	% e aksioneve	Vlera në Lekë	Vlera në mijë Lekë
Aksionarët								
Balfin Sh.p.k.	384,097	38,41	38,409,700	38,410	404,312	40,43	40,431,150	40,431
River Styxx	381,140	38,11	38,114,000	38,114	401,188	40,12	40,118,850	40,119
Adrian Koni	108,775	10,88	10,877,500	10,878	114,500	11,45	11,450,000	11,450
Ali Vishaj	76,000	7,60	7,600,000	7,600	80,000	8,00	8,000,000	8,000
Majllinda Demko	49,988	5,00	4,998,800	4,999	-	-	-	-
Total	1,000,000	100%	100,000,000	100,000	1,000,000	100%	100,000,000	100,000

16. Të ardhura nga qiraja financiare dhe kredidhënia

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga qiraja financiare	83,439	55,270
Të ardhura nga kredidhënia	13,127	3,000
Totali	96,566	58,270

Me përfundimin e qirasë dhe mbas shlyerjes së detyrimit, qiramarresi behet pronari i ligjshëm i aktivitetit të marrë me qira.

17. Te ardhura te tjera nga veprimtaria

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tarifa komisioni	316	377
Te ardhura nga penalitetet	4,985	2,078
Te ardhura nga rikuperimi i klienteve të keqinj	30	244
Te ardhura nga interesat e deftesës tregtare	-	215
Te ardhura nga shitja e aktiveve të qendrueshme	111	187
Totali	5,442	3,101

Tarifa e komisionit lidhet me tarifen e disbursimit që aplikohet në momentin e disbursimit të qirasë financiare dhe që shpërndahet përgjatë maturimit të qirasë financiare.

Të ardhura nga interesat e deftesës tregtare përfshin interesat e përfituar nga deftesa tregtare blerë nga Shoqëria, në bazë të marrveshjes ligjore të nënshkruar midis Balfin sh.p.k dhe Final sh.a më 30 qershor 2016 dhe aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas vendimit nr 58 datë, 28 prill 2016.

Final sh.a.
Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2017

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

18. Shpenzime për personelin

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pagat e personelit	32,919	22,158
Shpërblime	-	3,983
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,513	3,408
Totali	37,432	29,549

19. Shpenzime të tjera operative

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,074	1,347
Kancelari, karburant, transporti	1,657	1,064
Qira	2,713	1,692
Komision ndaj Neptun sh.p.k dhe cash credit	7,304	3,638
Komision për mbledhjen e debitorëve të këqinj	1,090	770
Shpenzime personeli nga jashtë ndermarjes	96	31
Mirembajtje dhe riparime	2,159	793
Shpenzime uje, energji elektrike	655	638
Shpenzime auditimi dhe konsulence	863	336
Shpenzime operative të tjera	787	478
Sherbime bankare	451	-
Gjoha nga tatimet	679	-
Shpenzime nga mosarketimi	133	53
Shpenzime për publicitet, reklama	1,088	500
Totali	21,749	11,340

20. Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Te ardhura financiare	24	58
Humbje neto nga kursi i këmbimit	6	(82)
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto	30	(24)

(të gjitha vlerat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

21. Tatimi mbi fitimin

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatim fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime tatimi janë vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzimi i tatimit aktual mbi fitimin	(6,219)	(2,766)
Te ardhura nga tatimi i shtyrë mbi fitimin	226	180
Shpenzimi total i tatimit mbi fitimin	(5,993)	(2,586)

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	27,562	14,562
Shpenzime te panjohura	13,900	3,880
Fitimi i rregulluar me shpenzimet e panjohura	41,462	18,441
Humbje te mbartuara	-	-
Fitimi fiskal	41,462	18,441
Tatim fitimi	6,219	2,766

22. Transaksione me palet e lidhura

Gjatë aktivitetit të saj Shoqëria ka hyrë në disa transaksione tregtare me palët e lidhura. Këto transaksione janë kryer në kushte normale të tregut. Transaksionet janë analizuar më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Balfin Group		
Shpenzime komisioni	6,493	3,600
Kompensimi i drejtimit		
Shpenzime paga	4,800	4,800

23. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje mbas dates se raportimit te cilat mund të kërkojne rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërise.